



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 1366/11 Prot.

Lushnje më, 15/02/2023

PROJEKT-VENDIM

NR. 14 DATË 15/02/2023

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË PASURIVE ME NR. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9, 169/7, 169/45, 169/8 DHE 169/52, TË NDODHURA NË ZK. 1020, FSHATI ALLPRENAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOLEM.”**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë \_\_\_/\_\_\_/2023 në mbështetje të : nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, gërma “e”, pika 1 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, V.K.M-së nr.818, datë 29.11.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Golem, të Qarkut të Fierit”, sot Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, nenit 801 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe V.K.M-së nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve ,të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera dhe enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, kreu 1, pika 7, me kërkesë të Drejtorisë Juridike dhe Zyrës së Menaxhimit të Aseteve, Këshilli Bashkiak :

**PROPOZOJMË:**

**I.** Të miratoj dhënien me qira të pasurive me nr. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9, 169/7, 169/45, 169/8 dhe 169/52, të ndodhura në ZK. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem për një periudhe 20 (njetzetë) vjeçare.

**II.** Për lidhjen e kontratës të zbatohen procedurat e përcaktuara në V.K.M-në nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve ,të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera dhe enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar”.


III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**PËR ZYREN E MENAXHIMIT TË ASETETEVE**


Liri Murati

Sara Manoku



**DR. DREJTORIA JURIDIKE**

Bedri Hida



**KRYETARI I BASHKISË**

ERISELDA SEFA

